




IERATIKON








ANNO DOMINI MCCCCLXXII

IERATIKON





PARAVUMIA

PARAVUMIA

Prifti me Diakanin kjëndrojën perpara Derës e Bukurë të Ikono-stasit bëjnë tri metanie.

Diak.: Bekò, o Zot!

Prifti: I bekuar kloft Perëndia jinë, përherë, nani e për gjithëmonë e për jetë të jetëvet.

Diak.: Amin

Rregji i kjielliës çë na përgëzon, Shpirti i së vërteties çë je gjithasajtën e çë gjithkjishë mblon, Tërsori i të miravet çë gjellë dhuron: eja e rri me ne e pastrona nga cëdo mëkatë e ruana, o i Mirth, shpirtrat t'anë.

Shejt Perëndi, Shejt i Fukjishëm, Shejt i Pavdekshëm, kij lipisi për ne. (Tri herë)
Lëvdi past Ati, Biri e Shpirti i Shejt, nani e për gjithëmonë e për jetë të jetëvet. Amin

Trini gjithë e shejte, kij lipisi për ne; ndëjena, o Zot, mëkatët t'ona; mos kujtò, o i Madh'in'Zot, ftesat t'ona; vërrej, o i Shej, e kij kujdes për sëmundat t'ona paj embrit t'ënt.

Lipisi, lipisi, lipisi, o i Madh'in'Zot.

Lëvdi past... nani e për...Amin.

Ati jinë..

Prifti: Se jotia isht Rregjëria, fukjia, e lëvdi: e Atit, e Birit dhe e Shpirtit Shejt, nani e për gjithëmonë e për, jetë të jetëvet. Amin.

Ti kijna lipisi, o i Madh'in'Zot, Ti kijna lipisi; se tue na u lipsur neve kush t'na ruanjë, Tij këtë parkalesi, si Rrekjë e si Zot, na të mëkatruamit faliëm: Ti kijna lipisi!

Lëvdi...

O i Madh'in'Zot, Ti kijna lipisi, se po tek Ti shpre sojëm na; mos u zëmbërò me ne fort kekjë, e mos kujtò ftesat e paligjësit t'ona; po vërrejna edhë nani si i dhëmbëshëm, e neve nga armikjët t'anë Ti shpëtò; se Ti je Perëndia jinë e na populli jit; të gjithë bër nga duart t'ote, e shejtin émbër t' ént kemi thërritur na.

Nani...

Të lipisis s'ate derën sbillëna neve Ti, o e bekuamia Mëm'e t'Lartit; na që kemi shpres tek Ti ngë mënd'shpresojëm m'kotë; shpëtofshim na po për Tij nga kekjëndodhiet; se Ti je, o Mëme, shpëtimi i gjithë gjindes e krështerë.

Pranë venë përpara Ikonës të Krishtit ujën kriet e thonë:

Na i përmisemi Fitirës t'ënde e dëlirë, o i Mirth, tue lipur ndëjesën e mëkatëvet t'ona, o Zoti Krisht Perëndi. Se Ti deshe vetëm e vetëm t'ishe me kurmin vierr në krikje sa të liroje neve nga duart e të markuamit.

Andai tue dhënë hir Tij, po thërresiëm: Mbëlove gjithësin me harë; o Shpëtuesi jinë, posa jerdhe të liroje jetën.

Kështu edhe përpara Ikonës të Mëmës të t'in' Zoti:

O Mëma e Perëndis, burimi i lipisis, bëna të mirë për lipisin t'ënde; prir siun t'ënt mbi popullin t'ënt se ka mëkatruar; dëftona, si gjithëmonë ke bër, fukjin t'ënde. tue shpresuar mbi Tij, të thomi: FALEM! si një herë Gavriili, i pari të Ushtrivet të Kjielliës.

O i Madh'in 'Zot, ndej dorën t'ende nga të lartit e ndenjes s'ate, tue më dhënë fukji te ki shërbim i shejt; sa tue rrijtur pa ftes përpara të dreruashëmes Therorë jote, u mëndë mbaronjë të papërgjakshmen Flijë.

Se jotia isht fukjia e lëvdia, për jetë të jetëvet.
Amin

Pra posa çë bërën tre metanie hijën te Vima tue thënë:

Ka të hinjë te Shpia jote e ka të falem përmist përpara Faltores s'ate të shejte me trembësirën t'ënde.

Brënda Vimës bëjën tri metanie e puthëjën Triesën Shejte edhe Vangjejn. Pranë çë njeri merr stiharin e 'tij e thonë (në vetëhë):

Diak.: Ndjemë, o Perëndi, mua të mëkatruamë e kijmë lipisi.

Diakani tue mbajëtur te dora e drejtë Stiharin me Orarin lip
Priftit bekimin:

Prifti i bekon tue bërë shengun e Krikjes Shejte

I bekuar Perëndia jinë, gjithëmonë, nanë e përherë
e në jetët e jetëvet. Amìn.

Diakani tue e vënë

Ka të gëzonet Shpirti jimë tek in'Zot, se Ai më
pëstroj me të veshurën e shëndeties, e më pëstolli
me mëndilin e drejtësis: si njëi dhëndërrri më vuri
kurorën, si një nuse më stolisi me bukuri.

Diakani si vu mëngën e drejt thotë:

E drejta jote, o i Madh'in'Zot, u lëvdua me fukji, e
drejta jote dhrëmoi armikjët. Edhë te madhëria
jote e lart Ti shprishe gjithë atà që vunë ballë me
Tij.

E mbi të shtrëmbërën:

Duart t'ote më bënë e më gëshën: ëmë ndëlgjim
dhe urdhurimet t'atë do të mësonjë.

Prifti bekon Stiharin e tij tue thënë:

Ka të gëzonet Shpirti jimë tek in'Zot, se Ai më
pëstroj me të veshurën e shëndeties, e më
pështolli me mëndilin e drejtësis: si njëi dhëndërrri
më vuri kurorën, si një nuse më stolisi me buku-
ri.

Pranë merr e vu:

Bekuar kloft Perëndia që derth hiret e vet mbi priftrat e'tij, si vaj erësh mbi kriet, që kullon mbi miekërrën e Aronit, që rrieth njer te pëlkjiri i së veshurës s'Tij.

Edhë me brezin:

Bekuar kloft Perëndia që më rrethoi me fukjì e që më bë gjithë i pa kjertuashëm dhromin t'im.

Pran Prifti merr mëngën e parë e thot:

E drejta jote, o i Madh'in'Zot, u lëvdua me fukjì, e drejta jote dhrëmoi armikjët. Edhë te madhëria jote e lart Ti shprishe gjithë atà që vunë ballë me Tij.

Edhë me të ditën:

Duart t'ote më bënë e më gjeshën: ëmë ndëlgjim dhe urdhurimet t'atë do të mësonjë.

Pra në ka nderin të vunjë Epigonatin thot:

Rrethò, o i Fukjishëm, ijët t'ote me shpatën dy presie për stolin t'ënde e bukurin. Ndej harkun e shkò përpara i gëzuar e rregjërò për të vërtetën, bukurin e drejtësin e te shërbise të mëdhà ka të të kjellënjë e drejta jote, për herë, nanì, e për gjithëmonë e për jetë të jetëvet. Amìn

Pra merrë Fëllonin e bekon dhë e puthë e thot:

Priftrat t'atë, o i Madh'in'Zot, kanë të vishen me drejtësi; e Shejtrat t'atë kanë të gëzonen e kanë

të bëjnë harë, përherë, nanì e për gjithëmonë e për jetë të jetëvet. Amin

Pranë kjasen te Protesi lajën duart tue thënë:

Dua të lanjë duart t'ime ndër të pafajshmit; e dua vete rreth Therores s'ate, o i madh'in'Zot, sa të gjegjemë zërin e lëvdìs s'ate, e të rrëfienjë gjithë famasmët t'ote.

Kam dashur, o i Madh'in' Zot, bukurin e shpis s'ate, e vendin teku kjëndron lëvdia jote. Mos më sos bashkë me të mëkatruamit shpirtin t'im, as me njerëzë gjakërash gjellën t'ime: te duart e'tire isht e kekjia, e plot me të dhëna isht e drejta e' tirë. Por u kam jezur në paligjësi: spëtòmë, o i Madh' in'Zot, e kijëmë lipisi, se këmba jime u mba te dhromi i drejt e dua të të bekonjë, o i Madh'in'Zot, te mbledhietë.

Te Protesi bëjnë tre metanie e thonë:

Ndëjemë, o Perëndi, mua të mëkatruam e kijëmë lipisi.

Prifti thot:

Nga nëma e ligjës na shpërbleve me gjakun t'ënt të shtrejt: Ti, o i Madh'in'Zot, te krikjia me gozhda i vierr, me shtisë i shpuar, na prure njerëzëvet pavdekjen: o Shëndeta jonë, levdi Tij!

Diak.: Bekò, o Zot

Prifti: Bekuat kloft Perëndia jinë, per herë, nani e për gjithëmonë e për jetë të jetëvet. Amin.

Merrë Bukën Shejte me shtizën bën tri herë shengun e Krikjes Shejte e thot:

Për kujtim të t'in'Zoti, Perëndi e Shpëtues i jinë, Iisu Krishti. (Tri herë)

Si një dele kle kjellur për të thertur.

E si kjenkjë i pafajshëm, përpara atij çë e kjeth, i pa zërë, ashtu ngë e sbill gojën e'Tij.

Te përunjësia e'Tij, gjikimi i'Tij kle ngrëjtur. E jinin e'tij kush do t'e rrëfienjë ?

Se kle ndsierr nga dheu gjella e'tij. Isht thertur kjenkji i Perëndis, Ai çë nzier mëkatën e jetës, për gjellën e shëndetën e jetës.

E një nga ushtarët me shtizën i shpoi brinjën e'tij, e duall një i herie Gjak e Ujë, e ai çë e pa bënë deshmi e deshmi e'tj isht e ftetë.

Diakani vu te kallaçi verë e ujë tue thënë:

Bekò, o Zot, bashkimin e shejtë

Prifti tue bekuar thot:

Bekuar kloft bashkimi të shërbisevet shejte t'ote, për herë, nani e për gjithënonë e për jetë të jetëvet . Amin.

Prifti pret te parën meridhës e vu te ana e drejtë të Bukësë Shejtë e thot:

Për nder e kujtim të gjithë të bekuames, dhe të lëvduashmes Mëmë të Perëndis e po Virgjërë Mëri, paj t'saj, o i Madh'in'Zot, prit mirë këtë Flijë mbi Theroren t'ënde të kjiellëshme.

Tek e drejta jote kjëndroi Mbretëresha, e pështruar, e veshur dhe e stolisur me pethëka të arta.

Prifti merrë nj'atër meridhës e vu te ana e shtrëmbër e thot:

Për nder e kujtim të Krieëngjëjvet të mbëdhenjë Mihail e Gavriil e të gjithë Fukjivet të kjielliës pa kurm.

Prifti për nga një thot:

Të të ndershmit e të lëvdushmit Profet e Paradhromë Janë Pagëzor; të Shejtravet të lëvduashmë Profetra: Moiseut e Aronit, Iliut dhe Eliseut, Davidhit i Jesseut e të tre dielmëvet të shejt, Danielit profet e të gjithë Shejtravet Profetra.

Të Shën Pietrit e të Shën Palit Apostoj të lëvduashmë e të për mendëshmë e të gjithë Shejtarvet Apostoj.

Të të madhit Shën Vasij, Shën Gregorit Theologë e të Shën'Janit Gojart, të Shën Athanasit e Shën Kjirilit, të Shën Kollit të Mirës, Shejtra këtë, ndër

Atërat Shejtë, Mieshtra të mbëdhenjë të besës e Jerarkjë e të gjithë Sheitrvet Jerarkjë.

Të të parit deshmor e arkjidiakër Stefanit e të Deshmorëvet të mbëdenjë Shën Mitrit, Shën Gjergjit, Shën Theodorit e të gjithë Shejtrvet Deshmorë.

Të Shejtrvet e Thavmëbërës Anargjërë Shën Kosmit e Shën Damianit, Shën Kjirit e Shën Janit, Shën Panteleimonit e Shën Ermolaut e të shejtrvet anargjirë.

Të Gjishëravet t'in'Zoti të shejtë e të drejtë Jakinit e Anës, të Shejtit ... që sot kujtojmë e të gjithë Shejtrvet paj të çilëvet ruana, o Perëndi.

Të Atit t'ënë ndër Shejtrat Janë Gojartit, Kriepiskopit të Kostantinopolit.

Në thuhet Mesha e Shën Vasjit shtonet:

Të Atit t'ënë ndër Shejtrat Shën Vasjit të Mathë Kriepiskopit të Kjesaresë të Kapadhokjis

Kujtoui i iMadh' in ' Zot, që njeriun do mirë, për gjithë Despotërat me besën e drejtë, për Despotin t'ënë . . . , për të ndershmen Priftëri e Diakoni në Krisht, për gjithë klerin e për gjithë vëllezërit t'anë, që me ne janë të shërbimi shejt: priftra,

diakëra e gjithë vëllezëria jonë, që Ti sglodhe të kemë piesë me Tij, për lipisin t'ëndë, o i Zot gjithë i mirë.

Për kujtim e ndëjes të mëkatëvet të të lumtit stisorë të kësaj klishe shejte.

E kujtou për gjithë ata Atëra e Vëllezërët 'anë të drejtë në besë që u kjëlluan gjumi me shpresë te të ngjallurit të gjellës të pasosme, o i Madh'in' Zot, që njeriun do mirë.

Prifti posa që kujtoi gjithë Shejtrat merrë të jera meridhës e i vu përposhë e zë fill nga Episkopi kujton gjithë të gjallët e të vdekurit e si sosë thot për atë:

Kujtou, o i Madh'in'Zot, për mua të mëkatruam e ndjemë çëdo mëkatë e dashur edhe padashurë.

Diak.: Bekò, o Zot, livanin

Prifti: Tij, o Zoti Krisht Perëndia jinë, të faliëm livanin për të bukurën erë të shpirtit, që Ti do te pretëshë te Theroria jote te kjiellia e të na dërgosh neve Hiret e Shpirtit t'ënt gjithë' i shejt

Diak.: Parkalesiëm t'ën Zonë

Ylli jerdhi e u mba atië sipër tek u ish Diali.

In'Zot rregjëron e vishet me nder të mathë;
In'Zot vishet e me fukji rrethonet.

Mirësia jote,o Zoti Krisht,pështroi kjielliatë; e
dheu ishte plotë me lëvdin t'ënde.

Pështrona nën hjes e krahëvet t'atë, mbaj
llargu nesh çëdo armik o kundrështor. Jipi
pakjen,o i Madh'in'Zot,gjellës t'ënë;kijë lipisi
për gjithë ne edhe për gjithënjeri, e shpëtò
shpirtrat t'anë, si i mirë e çë njeriun do
mirë

Bekuarë Ti je,o Perëndia jinë,se kështu të
pëlkuje. Lëvdi Tij!

Për herë,nani e per gjithëmonë e mbë jetë...

Mbi këtë Dhurata të shtrejta të falura.
parkalesiëm t'ën 'Zonë.

Perëndi,Perëndia jine çë Bukën e Kjiellies për të
ngrënë gjithë jetës Ti dërgove: Tën' Zonë
Perëndin, Iisu Krishtin,Shpëtues,liruas e
Mirëbërës, çë na bekon e na shejtëron, Ti vet bëkò
këto Dhurata e priti mirë te Theroria jote te
kjiellia. Kujtou,si i mirë e çë njeriun do mirë,
për ata çë t' i prurën e për kë ata Të' i
prurën, e neve ruana të pastërë te shërbesa
shejte të misterëvet t'atë të perëndishmë.

Se ishte i shejtëruar e i bekuar gjithë i
ndershëmi e i madhërushëmi embri jite: t' Atit,
t' Birit e të Shpirtit Shejt, nani e për gjithëmonë e
mbi jetë të jetëvet.

Lëvdi Tij,o Perëndia jinë,lëvdi Tij.

Lëvdi past Ati....

Zoti krisht,i vërtetë Perëndia jinë,çë u ngjall nga të vdekurit, paj të po Virgjërës e Shën Mëri e dëlira Mëma e Tij,e paj të Atit shejt Jani Gojart e paj të gjithë Shejtravet,na paçit lipisi e na shpëtoft si i mirë e çë njieriun do mirë,Amìn.

DOXOLOJIA

Lëvdi Tij,çë dritën na dëfton e çë Jetën dritëson!

Lëvdi në të lartitë Perëndis e mbi dhe pakje,ndër
njerëzit vulnes'e mirë

Imnojëm Tij ,bekojëm Tij,adhurojëm Tij,
lavdërojëm Tij,falënderojëm Tij për lëvdin t'ënde
të madhe.

O Zot,o Mbret i kjiellit Perëndi, Ati i
gjithëmëshim.

O Zot,Bir i vetëm,lisu'Krisht;edhe Shpirt i Shejt.

O Zot Perëndi, kjenkji i Perëndis. i Atit Bir,çë
ndsier mëkatët e jetës; lipisi për ne,o Ti çë ndsier
mëkatët jetës.

Prit mirë lutien t'ënë,Ti çë rri ujur tek e drejta e
Atit e kijna lipisi.

Se Ti vetëm je Shejt,Ti vetëm je Zot,lisu'Krisht: në
lëvdi të Perëndis Atit.Amin

Ditë për ditë do t'bekonjë Tij, do t'lavdëronjë
embrin t'ënt për jetë e mbë jetë të jetës.

Bëna të mirë,o Zot,te kjò ditë të ruhemi na të
pamëkatë.

I bekuar je,o Zot,Perëndia i Atëravet t'anë, dhe

embri jit isht i kënduar e i lavdëruar më jetë të jetëvet. Amin

Klofshit, o Zot lipisia jote mbi ne, ashtu si kemi shpresuar tek Ti.

I bekuar je, o Zot, mësomë Ti të drejtat t'ote. (Tri herë)

O Zot, Ti pështrimi ke klënë për ne bres pas brezi. U thash: O Zot lipisi për mua; shëndoshëm shpirtin, se përpara Teje mëkatrova.

O Zot tek' Ti u kam gjetur pështrim, mësomë të bënj vullimin t'ënt, se Ti je Perëndia jim.

Se tek Ti isht burimi i gjellës; te drita jote do t' shoiëm na dritë.

Zgjerò lipisin t'ënde mbi ata që të njohiën.

Shejt Perëndi, Shejt i fukjishëm, Shejt i pavdekshëm: kij lipisi për ne. (Tri herë)

Lëvdi. . . nani. . . Shejt i pavdekshëm: kij lipisi për ne.

Sot i jerdhi jetës shëndeta: lëvdojem Atë që u ngre nga varri, e që na dha gjellën; se tue shkelur vdekjen me vdekjen, na dha neve mundien e të madhen lipisi.

Përpara Triesës Shejte Prifti thot:

Ndëjemë,O Perëndi,mua të mëkatruam e kijëmë lipisì. (Tri herë)

Rregji i kjielliës çë na përgëzon,Shpirti i së vërteties çë je gjithasajtën e çë gjithkjishë mblon, Tërsori i së miravet çë gjellë dhuron: eja e rri me ne e pastrona nga cëdo mëkatë e ruana, o i Mirth,shpirtrat t'anë.

Lëvdi Perëndis te më i larti kjiell,pakje mbi dhe e mirësia njerëzëvet. (Di herë)

Sbillëmë buzët t'ime,o Perëndi, e goja jme da të rrëfienjë lëvdin t'ënde.

Diak.: Erdhi hera për të bëmën e t'in' Zoti.
Bekò,Zotëria jote.

Prifti: Bekuarë kloftë Perëndia jinë,për herë,nani e për gjithëmonë e për jetë të jetëvet.Amin.

Diak.: Parkalesë për mua,o Zot.

Prifti: Perëndia,i Mad'in'Zot,të ndrekjëshitë dhrometë t'atë për çëdò e bëme e mirë.

Diak.: Kujtou,o Zot, për mua.

Prifti: U kujtoftë in'Zot,Perëndia jinë,për tij te rregjëria e'Tij,nani e për gjithëmonë e për jetë të jetëvet. Amin.



MESHA E SHËN JAN GOJARTIT

Diak.: Bekò,o Zot.

Prifti: E bekuar Rregjëria e Atit,e Birit edhe e Shpirtit Shejt,nani e për gjithëmonë e per jetë të jetëvet.

Pop.: Amin.

Diak.: Në pakje parkalesiëm t'ën'Zonë.

Pop.: Lipisi, o i Madh'in'Zonë.

Diak.: Për pakjen s'larti e për shëndetën e shpitravet t'anë, parkalesiëm t'ën'Zonë .

Për pakjen e gjithë jetës tërë, e për gjëndresën e Klishëvet shejte të Perëndis, e sa t'ë gjithë një të jenë,parkalesiëm t'ën'Zonë.

Për këtë Shpi shejte e për gjithë ata që këtu hijën më besë, me poni e me trëmbësi të Perëndis,parkalesiëm t'ën 'Zonë.

Për Episkopin t'ënë (.),për të ndershmen Priftëri e Diakëri te Krishti,për gjithë Klerin e popullin,parkalesiëm t'ën'Zonë.

Për të Parëtë t'anë,për gjithë shpin e ushtrin

e'tire, parkalesiëm t'ën'Zonë.

Për Horën t'ënë e për nga Kjitet edhe horë e për gjithë ata ç'i jesiën me besë, parkalesiëm t'ën'Zonë.

Për motin e mirë, për burimin e pemëvet të dheut e për kjëronje të pakjëshëm, parkalesiëm t'ën'Zonë.

Për ata çë jane mbi dejt, për në dhromë, të sëmurë, çë janë e riejen, për ata çë jane në fulakji e për shëndetën e'tire; parkalesiëm t'ën'Zonë.

Sa të na ruanjë nga çëdo helme, mbri, rrëzikje e mieri, parkalesiëm t'ën'Zonë.

Ndihna, shpëtona, kijna lipisi dhe ruana, o Perëndi, me hirin t'ënt.

Tue kujtuar Zonjën t'ënë po virgjërë, Mëmën e Perëndis, Shën Mërin, gjithë shejte, të dëlirë, të bekuame dhe të lëvduame bash kë me gjithë shejtrat, na e njeri me t' jetrin edhe gjithë gjellën t' ënë i truajëm Zotit Krisht Perëndi.

Pop.: Tij, o i Madh'in'Zot.

Prifti: O i Madh'in'Zot, Perëndia jinë, fukjia e të çilit ngë mëndë ndëlgonet, dhe lëvdia isht e pakuptuashme, lipisia e pasosme e dashuria e parrëfieshme.

Ti, o i Madh'in'Zot, për sa e madhe isht mirësia jote, prir siun t'ënt mbi ne e mbi këtë shpi shejte: dërgò mbi ne e mbi ata që me ne të parkalesiën të shumtat lipisi dhe dhëmshurit t'ote.

Se Tij të nget nga lëvdi, nder e të përmisur: Atit, Birit e Shpirtit Shejt, nani e për gjithëmonë e për jetë të jetëvet.

Antifona e parë o Tipikà

Bukur isht të lëvdojëm t'ën'Zonë e të këndojëm embrin t'ënt, o i larti Perëndi.

Pop.: Për parkalesit të Mëmës t'ënde, o Madh'in'Zot, shpëtona.

Lëvdi...nani..

Pop.: Për parkalesit të Mëmës t'ënde, o i Madh'in'Zot, shpëtona.

Diak.: Pameta në pakje parkalesiëm t'ën'Zonë.

Pop.: Lipisi, o i Madh'in'Zot.

Diak.: Ndi hna, shpëtona, kijna lipisi dhe ruana, o Perëndi, me hirin t'ënt.

Tue kujtuar Zonjën t'ënë PoVirgjërë, 'Mëmën e Perëndis, Shën Mërin, gjithë shejte, të dëlirë, të bekuame dhe të lëvduame, bashkë me gjithë shejtrat, na e njeri me t'jetrin e

gjithë gjellën t'ënë i truajëm Zotit Krisht
Perëndi.

Pop.: Tij, o i Madh'in'Zot.

Prifti: O I Madh'in'Zot, Perëndia jinë, shpëtò popullin
t'ënt e bekò trazhgimin t'ënt. Ruaj në pakje
plotësin e Klishës s'ate. Shejtërò ata që duan
nderin e shpis s'ate: TI vet lëvdoi me fukjin
t'ënde të perëndishme, e mos na le neve, o
Perëndi, që tek TI vum shpresën.

Se jotia ë pushtetia, si edhe rregjëria e
fukjia e lëvdia: e Atit, e Birit edhe e
Shpirtit Shejt, nani e për gjithëmonë e për
jetë të jetëvet.

Pop.: Amin.

Antifona e ditë o Tipikà

In'Zot rregjëron e pështronet me nder të mathë; in'Zot
vishet e me fukji rrethonet.

Pop.: Për parkalesit të Shejtravet t'atë, o i
Madh'in'Zot, shpëtona.

Lëvdi...nani...

O I vetmi Bir e Fialë e Perëndis, Ti që je i
pavdekshim, deshe të njerëzoeshe e të
mirrie kurm për shëndetën e shpirtit t'ënë në
gji të shejtes Mëmë e PoVirgjërë e Shë ' Mëri.

Ti që pa ndërruar njeri u bëre e vun ngrikj, o Krisht o Perëndi, me mortien t'ënde mortien shkele. Ti që je një nga Trinia shejte i bashkë lëvduar me Atin e me Shpirtin Shejt, jipna gjellë të pasosme.

Diak.: Pameta në pakje parkalesiëm t'ën'Zonë.

Pop.: Lipisi, o i Madh'in'Zot.

Diak.: Ndhina,shpëtona,kijna lipisi dhe ruana, o Perëndi,me hirin t'ënt.

Tue kujtuar Zonjën t'ënë PoVirgjërë, Mëmën e Perëndis, Shën Mërin, gjithë shejte, të dëlirë, të bekuame dhe të lëvduame, bashkë me gjithë shejtrat, na e njeri me t'jetrin e gjithë gjellën t'ënë i trujëm Zotit Krisht Perëndi.

Pop.: Tij, o i Madh'in'Zot.

Prifti: O Ti që na dhë hir të bëjëm këtë parkalesi gjithë bashkë e me gjithë një zërë, Ti që takse t'i japësh çdò dy a tre vetë vënë bashkë të lipjënë mbi embrin t'ënt, Ti vet edhë nani mbarò për të mirën t'ënë lipiet e shërbëtorëvet t'atë, tue na bër të njohiëm të Vërtetën t'ënde te këjò jetë e tue na dhënë te jatra gjellën e pasosme.

Se ti je Perëndi i mirë e që do mirë gjithënjëri e na të japiëm lëvdì Tij: Atit, Birit edhe Sphpirtit Shejt, nani e gjithmonë e per jetët e

jetevet.

Pop.: Amin.

Antifona e tretë o Makarismì

Ejani të gëzonemi tek in'Zot; ngrëjëm zërin me hajdi Perëndis, shëndeta jonë.

Pop.: Shpëtona, o i Biri i Perëndis, i ngjalluri së vdekurish (i famasëshëm ndër Shejtrat), neve çë të këndojmë: Alliluia.

Prifti: O i Madh'in' Zot, Perëndia jinë, Ti çë te kjiellia vure urdhurë e ushtri Ëngjëjish e Arkëngjëjish për të shërbier lëvdin t'ënde, Ti kështù edhe bënë së bashkë me ne të hijën Ëngjëjitë shejtë, sa edhe bashkë me ne të shërbejën lëvdin t'ënde. Se nga lëvdi, nga nder e të përmisur të nget Tij: Atit, Birit e Shpirtit Shejt, nani e për gjithëmonë e për jetë të jetëvet. Amin.

HIRIA E VOGËL

Diakani hinë te Vima merrë Vangjejin Sheitë çë i jep Prifti e bashkë dajën e tue i lipur bekimi thot:

Diak.: Bekò, o Zot, hirien shejte.

Prifti: Bekuar kloft hiria e Shejtravet t'atë, gjithëmonë, nani e përherë, për jetë të jetëvet. Amin.

Prifti: Ejani t'i falemi e i përmisemi Zotit Krisht. Shpëtona, o i Biri i Perëndisë, i ngjalluri së vdekurish, (i famashëm ndër Shejtat) neve çë të këndojmë: Alliluaia.

.....

Prifti: O Perëndi i shejt, çë prëhe ndër Shejtrat, çë je kënduar nga Serafimët me kënkën trishejte, e je lëvduar nga Hjeruvimët e je falur përmist nga gjithë Fukjit e Kjielliës; Ti çë nga e mosklënia prure në të klënë të gjithë çëdo janë; Ti çë gjeshe njeriun si Fitira jote sa të të glisië dhe e stolise me Hired t'atë, çë jep dituri e urtësi kuj te lip, e ngë e nzier siun nga i mëkatruami, por i dhe pendimin për shëndetë; Ti çë na bëre neve të mierët dhe të pavlershmit shërbëtorë t'atë, të mirë të rrijmë te këjò herë përpara lëvdisë therorës s'ate e të të biem Tij dëtirën e të përmisurit edhë të lëvdimit, TI, o i Madh'in'Zot, edhë nga goja jonë, nga na të mëkatruamë prit mirë këtë kënkë triherëshejte e me mirësin t'ënde prir siun i lipisiar, ndëjena neve çëdo mëkatë e dashur e padashur; shejtërona shpirtrat e kurmet t'anë e na dhurò sa të të shërbejmë si nget

gjithë ditë e gjellës t'ënë, paj të Mëmës e t'in'Zoti e paj të gjithë Shejtravet, që të kanë pëlqier që prej jetie.

Diak.: Parkalesiëm t'ën'Zonë .

Pop.: Lipisi,o i Madh'in'Zot.

Prifti: Se Ti je i shejt, o Perëndia jinë, e na të japiëm lëvdi Tij: Atit, Birit e Shpirti Shejt nani e për gjithëmonë e për jetë të jetëvet. Amin.

Pop.: Amín.

Shejt Perëndi, Shejt i fukjishëm, Shejt i pavdekshëm: kij lipisi për ne. (Tri herë)

Lëvdi past Ati, Biri e Shpirti Shejt, nani e për gjithëmonë e për jetë të jetëvet. Amin
Shejt i pavdekshëm, kij lipisi për ne.

Diak.: Fukji!

Pop.: Shejt Perëndi, Shejt i fukjishëm, Shejt i pavdekshëm: kij lipisi për ne.

Te dita e Pashkët e Pentekostës, e Krishlindies dhe e Epifanisë thuhet:

Oh! Sa në Krisht u pagëzuat, me Krishti ju u veshët': Alliluia.

Te dita e Krikjes e tek e treta e Diellëj e Kreshmëvet thuhet:

Krikjen t'ënde proskjinisiëm, o i Madh'in'Zot,
e Ngjallien t'ënde të shejte lëvdojëm.

Diak.: Urdhurò, o Zot.

Prifti: I bekuar Ai që vienë në embër të t'in' Zoti.

Diak.: Bekò,o Zot, thronin të lartë.

Prifti: I bekuar je Ti o i Madh'in'Zot që rri mbi
thronin e levdis te rregjëria jote mbi
Hjeruvimtë përherë, nani e për gjithëmonë e
për jetë të jetëvet. Amin.

Diak.: Vumji're! DIEJA! Gjegjemi!

...

Prifti: O i Madh ' in ' Zot që njeriun do mirë, bëj sa
të shkëlqjenjë te zëmbat t'ona drita e thIELLËT
për të njohur Tij si Perëndi e na sbill sit e
mendies t'ënë për të ndëlguar mësimet e
Vangjejit t'ënt: jipna trëmbërsirën e
urdhurimevet t'atë të lumë,akjë sa tue
shkelur dishirimet e kurmit,na mëndë
ruajëm dëtirët e shpirtit,tue kujtuar e tue
bërë gjithë atë që të pëlqjen Tij.
Se Ti je, o Krisht Perëndi, drita e shpirttravet
e të kurmëvet t'anë, e na të japiëm lëvdi Tij
bashkë me Atin t'ënt të pa zën fill e bashkë
me gjithë shejtin, të mirë e gjellëdhënës
Shpirt t'ënt, nani e për gjithëmonë e për jetë

të jetëvet.Amin.

BEKIMIN PËR VANGJEJIN

Diak.: Bekò, o Zot, atë ç'isht e vete të lajmëronjë Vangjejin të Shejtit Apostull e Vangjejtari (...)

Perëndia për parkalesit të shejtit, të Lëvduashëm Apostull e Vangjejtari... të dhëfshit vierrshë të lajmëroshë me shumë fukji, në mbarim të Vangjejit të të Dashurit Bir t'Tij, Zoti jinë Iisu Krishti.

Diakani merr nga duart të Priftit Vangjejin Shejt e del nga Vima e thot:

DIEJA! Shtuara, gjegjemi Vangjejin Shejt.

Prifti: Pakje të gjithëve.

Pop.: Edhe shpirtit t'ënt.

Diak.: Piesë te Vangjejit shejt si shkruan Shën... (Luk.Matth.Mar.Jani)

Pop.: Lëvdi Tij, o i Madh'in'Zot, lëvdi Tij.

Prifti: Gjegjemi!

...

Pop.: Lëvdi Tij, o i Madh'in'Zot, lëvdi Tij. Për shumë vietë, o Zot.

Diak.: Të gjithë po thomi me gjithë zëmber e me gjithë mendien t'ënë, po thomi.

Pop.: Lipisi, Lipisi, Lipisi, o i Madh'in'Zot!

Diak.: O Zot i gjithëmëndëm, Perëndia i Atërevet t'anë, na të parkalesiëm, Ti gjegjëna e kijna lipisi.

Kijna lipisi, o Perëndi, për sa e madhe isht lipisia jote, na të parkalesiëm, Ti gjegjëna e kijna lipisi.

Prifti: O i Madh'in'Zot, Perëndia jinë, prit mirë këtë parkalesi e glatë e të shërbëtorvet t'atë, e kijna lipisi për sa të shuma janë lipisit t'ote; e derth dhëmshurit t'ote mbi ne e mbi gjithë popullin t'ënt, që pret ngak Ti, burin e lipisivet t'ote.

Diak.: Parkalesiëm edhe për Episkopin t'ënë (...) e për të ndershëmen Priftëri.

Parkalesiëm edhe për vëllezërit t'anë: Priftëra, Diakëra, Kallogjerë e për gjithë vëllezërin t'ënë në Krisht.

Parkalesiëm edhe për lipisi, pakje shëndetë, shpëtim, kujdes, falie e ndëjes të mëkatëvet të shërbëtorëvet të Perëndis, që rrojën te kjo Horë.

Parkalesiëm edhe për ata të lumë e të paharruashëm që stisën këtë Klishë shejte e

për 'gjithë prindrat e vëllezërit t'ane që
vdikjën me besën, e që flën varrëzuar këtù e
ku do ndodhen.

Parkalesiëm edhe për ata që ndihën e
shërbejën mirë këtë e ndershëme klishë
shejte, për ata që i sbiren e i këndojën e për
gjithë popullin që këtu ndodhet e pret ngak
Ti të mëdhat e të shumtat lipisi t'ote.

Pop.: Për shumë vietë, o Zot.

Prifti: Se Ti je Perëndia i lipisis që njeriun do mirë
e na të japiëm lëvdi Tij: Atit, Birit e Shpirtit
Shejt, nani e për gjithëmonë e për jetë të
jetëvet.

Pop.: Amin.

.....

Diak.: Parkalesëni, ju katikumenjë, tën Zonë.

Pop.: Lipisi, o i Madh'in'Zot!

Diak.: Na të besmë per katikumenjët parkalesiëm
t'ën 'Zonë.

Sa t'i ket lipisi i Madh'in'Zot.

Sa t'i mënsonjën atireve Fialën e s'vërtetës.

Sa t'i vunjën bashkë me ne te Klisha shejte
katolike e apostolike.

Ndih, shpëtoi, kiji lipisi dhe ruaji, o Perëndi,
me Hirin t'ënt.

E ju katekumenjë ujëni kriet t'ajë t'in 'Zoti.

Pop.: Tij, o i Madh'in'Zot.

Prifti: O Perëndi i Madh'in'Zot, që rri tek i larti kjiell
edhe ke siun mbi të përunjtisë, Ti që dërgove
për shëndetën e njerëzëvet të vetëmin ler
Birin t'ënt Perëndin Zotin Isu Krisht, vërrej
shërbëtorët t'atë katikumenjë që kanë ujur
kriet përpara Teje, Ti priti te hera e mirë të
ken rilindien me pastrën e mëkatëvet, me të
veshurën e paprishëris, Ti mirri bashkë
brënda te Klisha jote shejte katolike e
apostolike e nëmëroi te shokjëria bashkë tek
i zgledhuri vathë jiti.

Sa edhe ata bashkë me ne të lëvdojën embrin
t'ënt, të gjithë ndershëmin, e të
madhëruashmin: të Atit, të Birit e të Shpirtit
Shejt, nani e gjithëmonë e për jetë të jetëvet.

Pop.: Amin.

Diak.: Sa jini ju katikumenjë të dilni; o
katikumenjë të dilni; sa jini ju katikumenjë
të dilni: mos të kjëndronjë këtu edhe një.

Na sa jemi të besmë pameta në pakje,
parkalesiëm t'ën'Zonë.

Ndihëna, shpëtona, krijna lipisi dhe ruana,

o Perëndi, me Hirin t'ënt. Dieja!

Prifti:

Të haristisiëm, o i Madh'in'Zot, e Perëndi i fukjivet, se na bënë të mirë nani të kjëndrojëm përpara therorës s'ate së shejte e përmistë të lipiëm lipisitë t'ote për mëkatë t'ona e për të padijturatë e popullit. Ti, o Perëndi, mirë me hir këtë parkalesi e na bën të mirë, sa të të faliëm Tij parkalesi e flijë të papërgjakshme për gjithë popullin t'ënt: e neve që na vure te këta të shërbier bën me fukjin e Shpirtit t'ënt të shejt, sa na të mëndë të pakjertuashëm e të pafajëshëm ndë deshmi të dëlirë të ndërgjegjes t'ënë në që do herë e vent të thërresiëm Tij, sa të na gjegjeshë e të na ftoneshë i butë paj të madhes mirësi s'ate.

Se Tij të nget nga lëvdi, nder e të përmisur: Atit, Birit e Shpirtit Shejt, nani e gjithëmonë e për jetë të jetëvet.

Pop.:

Amín.

Prifti:

Pameta në pakje parkalesiëm t'ën Zonë.

Ndihëna, shpëtona, krijna lipisi dhe ruana, o Perëndi, me Hirin t'ënt.

Dieja!

Pameta e shumë herë të përmisemi e të parkalesiëm Tij i mirë e që njeriun do mirë, sa tue gjegjur parkalesin t'ënë, të na

pastroshë shpirtrat e kurmet t'anë nga çëdo mëkatë mishi e shpirti. Bënna të mirë të kjëndrojëm përpara therores s'ate shejte. E atire çë me ne të parkalesiëm, o Perëndi, Ti dhuroi përparim gjellie e besie e ndëlghim së shpirti. Atire pra çë gjithëmonë të shërbejëm me dre e trëmbësi e me dashuri, jipi sa pa ftesë e pa gjikjim të ken piesë te misteretë t'atë shejtë e te rregjëria jote në kjiellë.

.....

Sa na të ruajtur, për herë, nga pushtetia jote të japiëm lëvdi Tij: Atit, Birit e Shpirtit Shejt, nani e gjithëmonë e për jetë të jetëvet.

Amin.

Pop.: Na këtù Hjeruvimtë mistikjisht tue shfakjurith, edhe na Trinis shejte gjellësore trishejten kënkë tue kënduarith, po lëmë nani mbë njanë e gjellës çëdo kujdes: sa të presiëm Rregjin...

Prifti: Mosnjeri çë isht lidhur me dishirime e me pëlkjime mishi, isht i mir të vinjë, të kjaset, të të shërbenjë Tij, o Rregji i lëvdis, se të shërbierit Tij isht gjagjë të mathë, të dreruashëm, edhë për fukjit e kjielliës.

Por për dashurin t'ënde e parrëfieshme edhë pa matur, u bëre njeri si ne pa u prishuar dhe pa ndërruar e kleve bër krieprifti jinë e si Zoti i gjithësis neve na dërgove shërbesën

shejte të ksaj flije e papërgjakëshme.

Se vetëm Ti, o i madh'in'Zot, Perëndia jinë,
urdhuron te kjiellia e te dheu, Ti që rri mbi
një thron hjeruvimshmë, Ti i Zoti i
Serafimvet, Rregji i Israelit, i vetëm shejt që
prëhe ndër Shejtrat.

Tij të truhem, i vetëmi i mirë e i but për të
gjegjur: vërrej mua të mëkatruam e të
paviefshim shërbëtuar t'ënt: pastrom
shpirtin e zëmbërën nga ndërgegje e kekjë, e
mua i veshur me dhuratën e priftëris më
bën të mir të rri, me fukjin e Shpirtit Shejt,
përpara ksaj triesie shejte e të bënë flijë
kurmin t'ënt të dëlir e të shejt e gjiakun t'ënt
të shtrejt.

Andai u të kjasem tue përujur kriet t'im e të
parkales: mos prier fakjen t'ënde ngak u e
mos më lësh mbë nj'anë, nga rrethi i bijvet
t'atë.

Por bëj sa u i mëkatruam e i pavjefshim
shërbëtuar jiti, të të fal Tij këtë Dhurata se
Ti je Ai që dhuron e që dhurone, Ti je Ai që
pret dhurata e jipe dhuratë o Krisht Perëndia
jinë e na japiëm lëvdi Tij bashkë me Atin
tënt të pa zënë fill e me gjithë shejtin e të
mirë e gjellëdhënës Shpirt t'ënt, nani e për
gjithëmonë e për jetë te jetëvet. Amin.

Prifti: Na këtë Hjeruvimtë mistikjisht tue
shfakjurith, edhe na Trinis shejte gjellësore

trishajten kënkë tue kënduarith, po lëmë
nani mbë njanë e gjellës çëdo kujdes:...

Diak.: ...sa të presiëm Rregjin e gjithësis, çë
rrethuar vien pa parë tufa tufa Ëngjëjish:
Alliluia. (Tri herë)

Prifti: Bekomëni, Vëllezëritë t'imë, e ndëjemëni mua
të mëkatruam.

Ndjemë o Perëndi mua të mëkatruamë e
kijmë lipisi.

Ngrëni duart tuaja mbi shërbiset të shejte e
bekoni t'ën'Zonë.

Diak.: U kujtoft Perëndia i Madh'in'Zot për ne të
gjithë te Rregjëria e' Tij përherë, nani e për
gjithëmonë e për jetë të jetëvet.

Pop.: Amin...Sa të presiëm Rregjin e gjithësis, çë
rrethuar vien pa parë tufa tufa Engjëjishë.
Alliluia. (Tri herë)

Diak.: Për priftërinë t'ënde u kujtoftë Zoti Perëndi te
Rregjëria e tij, gjithëmonë, nani e përherë e
në jetët të jetëvet.

Prifti: Për dhiakërinë t'ënde u kujtoftë Zoti Perëndi
te Rregjëria e tij, për gjithëmonë, nani e
përherë e në jetët e jetëvet. Amin.

Bujari Josif Kurmin t'ënt të pangar e sdripi
nga Krikjia e në pulhur të pastërë e pështolli

e me aromë te një varr i ri me lip të mathë e vuri.

Atëherë kanë të të bien viçëra mbi Theroren t'ënde. (**Tri herë**)

Prifti: Kujtò mua, o vëllà e shok te Mesha shejte.

Diak.: U kujtoftë Perëndia i Madh' in'Zot për Priftërin t'ënde te Rregjëria e'Tij.

Parkales për mua, vëllau jim.

Prifti: Shpirti Shejt ka të vinjë mbi tij e fukjia e të Lartit ka të t'pështuellënjë.

Diak.: Shpirti vetë ka të jet bashkë me ne gjithë ditë e gjellës t'ëne.

Kujtò mua, Zotëria jote.

Prifti: U kujtoftë Perëndia i Madh' in'Zot te Rregjëria e'Tij, për herë, nanì e për gjithëmonë e për jetë të jetëvet Amin.

Diak.: Le të mbarojëm parkalesin t'ënë t'in'Zoti.

Për të shtrejtatë dhurata këtù paravuna, parkalesiëm t'ën'Zonë.

Për këtë shpi shejte e për gjithë ata që këtu hijën me besë, me poni e me trembësi të Perëndis, parkalesiëm t'ën'Zonë.

Sa të na ruanjë nga çedò helmë, mbri,
rrëzikje e mieri, parkalesiëm t'ën'Zonë.

Prifti: O i Madh'in'Zot, Perëndi i gjithë mëndëshëm,
i vetmi shejt, që pret mirë flijë lëvdimi nga
ata që të thërresiën me gjithë zëmber, mirr
këtë parkalesi ngak na të mëkatruamë, e
kjasna neve te Theroria jote e shejte e na
bënë të mirë të të faliëm Tij dhurata e flijë
shpirtullore për mëkatë t'ona e për të
padijturat e popullit. E bëna të mirë të
gjejëm hir përpara Teje, të jetë e pëlkjieme
flija jonë, e Shpirti i mirë i Hirit t'ënt të jetë
me ne e mbi këtë Dhurata që ndodhen këtu
përpara e mbi gjithë popullin t'ënt.

Diak.: Ndhina,shpëtona, kijna lipisi dhe ruana, o
Perëndi, me hirin t'ënt.

Të na shkonjë gjithë dita e mbaruame më se
më, e shejte, me pakjen, e pa mëkatë,
lipëmia t'in'Zoti.

Pop.: Gjegjëna, o i Madh'in'Zot.

Diak.: Engjëllin e pakjes që i besmë na kjellë te
dhromi i drejt e që ruan shpirtrat e kurmet
t'anë, lipëmia t'in'Zoti.

Ndëjesën e mëkatëvet e falien e ftesavet t'ona
lipëmia t'in'Zoti.

Të mirat e çëdo i duhet shpirtravet t'anë e
pakjen per jeten, lipëmia t'in'Zoti.

Kjëroin çë na vietet të gjellës t'ëne të e
sosiëm me pakje e me pendes, lipëmia
t'in'Zoti.

Sa të sosuri e gjellës t'ënë të jet si të
krështerë:pa dhëmbie, pa të kjërtuam, në
pakje e me mbrojtie të mirë përpara gjikjit të
dreruashëm të Krishtit, lipmia t'in'Zoti.

Tue kujtuar Zonjën t'ënë Povirgjërë, Mëmën
e Perëndis, Shën Mërin, gjithë shejte, të
dëllirë, të bekuame dhe të lëvduame, bashkë
me gjithë shejtrat, na e njeri me t'jetrin e
gjithë gjellën t'ënë i truajëm Zotit Krisht
Perëndi.

Pop.: Tij , o i Madh'in'Zot.

Prifti: Për lipisit e të vetmit ler t'it Biri,me të çilin je
i bekuar bashkë' me të gjithë shejtin, të mirë
e gjellëdhënës Shpirt t'ënt, nani e për
gjithëmonë e për jetë të jetëvet.

Pop.: Amin.

Prifti: Pakje të gjithëve.

Pop.: Edhe shpirtit t'ënt.

Diak.: Të duhemi mirë njeri me t'jetrin sa njëi
mendie të ligjërojëm.

Pop.: Atin', Birin e Shpirtin Shejt: Trinin me një të
klënët e të pandarshme.

Prifti: Të dua mirë, o i Madh'in'Zot, fukjia jime;
in'Zot kjëndresa jime, pështrimi jim e
shëndeta jime.

Diak.: Diert! Diert! Me urtësi! Vumëji're!

Pop.: U kam besë te një Perëndi, At i
gjithëmëndëm, çë bëri kjiellin e dheun, e
gjithë atò çë duken e atò çë ngë duken.
Edhë te një Zot, Iisù Krishti, i Biri i Perëndis,
I vetmiler, i çili leu nga Ati më para se gjithë
jetët; Dritë nga Dritë, Perëndi i vërtet nga
Perëndi i vërtet, i ler, jo i bër, gjithënjë i
klënie më Atin, për anë të të çilit
gjithëkjishë u bënë. I çili për ne njerëzë e për
shpëtimin t'ënë u sdrip nga kjiellia e mori
kurm paj të Shpirtit Shejt e të Virgjërës Mëri
e u bë njeri. Kle vunë n' krikjë për ne nën
Ponts Pilatit, duroi e kle varrëzuar; e u ngjall
në të tretën ditë si thonë të Shkrumet; e u
ngjip te kjiellia e rri te ana e drej të Atit. E ka
të vinjë pameta me lëvdi të bënë ligjë mbi të
gjallit e mbi të vdekurit, Rregjëria e Tij ngë
ka për të sosur. E te Shpirti Shejt, Zot e
gje llëdhënës, çë buron nga Ati, e ë përmisur
e lëvduar bashkë me Ati e me Birin; e çë foli
për anë të Profetravet. Te Klisha, një, shejte,
katholike e apostolike. U rrëfienjë një
pagëzim për ndëjesën e mëkatëvet. Pres
ngjallien e të vdekurvet, e Gjellën e jetës së
jardhëshme. Amin.

Diak.: Le të rrim mirë! Rrim me trëmbësi! Vumëji're
të faliëm shejten Dhuratë në pakje.

Pop.: Lipisi, pakje, flijë lëvdimi!

Prifti: Hiri i t'in'Zoti Iisu Krishti, e Dashuria e Perëndis At, e të Marrit pjesë te Shpirti Shejt, kloft me ju të gjithë.

Pop.: Edhe me shpirtin t'ënt.

Prifti: Ngrëjëm në të lartit zëmbtrat t'ona.

Pop.: I kemi tek in'Zot.

Prifti: Haristisiëm t'ën'Zonë.

Pop.: Mirë isht e drejt t'i përmisemi Atit, Birit e Shpirtit Shejt: Trinis me një të klënët e të pandarshme.

Prifti: Mirë isht e drejt të të këndojëm, të të bekojëm, të të lëvdojëm, të të haristisiëm, të të përmisemi në çëdo vent të zotërimit t'ënt: Se Ti je Perëndi i parrëfieshëm, i pandëlguashëm, i padukshëm e i pakuptuashëm, Ti je gjithëmonë e i pandërruashëm: Ti e i vetmi ler Biri jit e Shpirti Shejt jiti. Ti nga e mosklëna na prure në të klënit e rar na ngrëjte pameta e tue bërë gjithëkjishë na kjelle mbi kjiellë e na dhe dhuratë rregjërin t'ënde të ardhëshëmen.

Për gjithë këtë, na të haristisiëm Tij e Birin t'ënt të vetmin-ler e Shpirtin t'ënt Shejt, për të gjitha: atò çë dim e atò çë ngë dim, për

atò çë duken e atò çë ngë duken, edhe për gjithë atò të mira çë na klen bërë neve.

Të haristisiëm edhe për këtë flijë çë deshe të mirrie nga duart t'ona, me gjithë se janë përpara teje mijëra Arkëngjëjë edhe mijë mijash Engjëjë: Hjeruvimt e Serafimt me gjasht krahë, me shumë sy, të përllart e çë fluturojën:

+E kënkën e mundësis tue kënduar, tue luritur, tue thërritur e tue thënë:

Pop.: I Shejt, I Shejt, I Shejt: Zoti Savaoth. Kjielli e dheu janë plotë me lëvdin t'ënde. Osannà te më i larti Kjiell. I bekuar ai çë vien në embër të t 'in' Zoti. Osanna te m'i larti kjiell.

Prifti: Edhe na, o i Madh' in 'Zot, çë njeriun do mirë bashkë me këto Fukji të lumëshme, thërresiëm e thomi: I Shejt je, edhe gjithë i shejt, Ti e Biri jit i vetmi ler e Shpirti jit i Shejt. I Shejt je e gjithë i shejt, e lëvdia jote isht e madhëruashme. Ti deshe akjë mirë jetën t' ënde, sa na dhe Birin t'ënt të vetmin ler, sa mosnjeri, çë ka besë tek Ai të sbiret por të ket gjallë të pasosme. I çili si jerdhi e posa çë mbaroi gjithë urdhurimet për ne, te nata çë kle perdhënë, a se më mirë, vetëm e vetëm u dha për gjellën e jetës: mori Bukën te duart e Tija të shejte, të delira, të pastëra, haristisi e bekoi, e shejtëroi e ndajti e ja dha Zënësvet e Apostojvet e 'Tij të shejte tue thënë:

+ Mirrni, hani: ki isht Kurmi jim, që çahet për ju për ndëjes të mëkatëvet.

Pop.: Amin.

Prifti: Edhe kështu me kjelkjin, si sosi të ngrënit e darkës tue thënë:

+ Pini nga ki të gjithë: ki isht Gjaku jim, të Dhiatës së re, që derdhet për ju e për shumë për ndëjes të mëkatëvet.

Pop.: Amin.

Prifti: Tue kujtuar nani këtë urdhurim të t'in'Zoti e gjithë atë që kle bëre për ne: Krikjen, Varrin, Ngjallien e triditëshme, të Hipurit në kjiell, të rrijturit në Thron tek e drejta e Atit e Jardien e ditë dhe të lëvdoshme.


Prifti: Na Tij të faliëm t'otet nga tote, ndër të gjitha e mbi të gjitha

Pop.: Të lëvdojëm, të bekojëm, të haristisiëm, o i Madh'in'Zot, e të parkalesiëm, o Perëndia Jinë.

EPIKLESI

Prifti: Edhe të dhurojëm këtë flijë të mendëçeme e të papërgjakëshme:
Të parkalesiëm, të lutemi e të lipiëm:

+ Dërgo Shpirtin t'ënt të Shejt mbi ne e mbi këtë Dhurata që kemi këtë përpara.





APOLITIKJA TË TË DIALLIAVET

APOLITIKJA TË TË DIALLIAVET

I

Kur guri kle vulosur nga Judhenjët e si ushtarët të ruajën kurmin të pangar, u ngreve tri ditësh, o Shelbues, gjellën jetës tue dhënë. Prandai e kjielliavet fukjit 'lurijën Tij, Gjellëdhënës: lëvdi Ngjallies t'ënde, o Krisht, lëvdi Rregjëris t'ënde, lëvdi kujdesit t'ënt, o i vetmi njeridashës.

II

Kur u sdripe nga vdekjia, o Gjellë e pavdekshme, atëherë Pisës vdekjien i dhe me të shkëlqierit e Hjynis, Atëherë nga nënshtresat e dheut të vdekurit ngjalle. Gjithë fukjit të larta ëngjëllore po thërresiën: o Gjellëdhënës Krisht, Perëndia jinë, lëvdi Tij.

III

Le të dëfrenen kjielliat, le të gëzonet dheu, se punë të mëdha bëri me krahun e 'Tij in'Zot. Ai edhe shkeli vdekjien me vdekjien; u bë i paralinduri i të vdekurvet. Nga gropa e Pisës neve na liroi, e jetës i dha të madhen lipisi.

IV

Të gzuamen e Ngjallies nduhtë si nga Ëngjëlli dsunë të t'in'Zoti dsënësëvet e prindravet mahkimin të helkjur Apostojvet me gëzim i thanë: kle mundur vdekjia u ngre Krishti Perëndi tue dhenë jetës të madhen lipisi.

V

Të panisëshmen Fialë me Atin e me Shpirtin çë leu nga Virgjëra për shëndetën t'ënë levdojëm të besmë e proskjimisiëm; se deshi me kurm të hipej në krikj e

mortien të duroj; e të vdekurit të ngjallëj me ngjallien
të lëvduashme e'Tij.

VI

Fukjit ëngjellore mbi varrin t'ënt e si të vdekurë ran
àta ç'e ruajën e mbeti Mëria tue kërkuar mbi varrin të
pangarin Kurmin t'ënt. Plakose ti Pisën pa klëne ngar
nga ajò përpokje Ti Virgjëreshën e gjellën i dhe; o i
ngjalluri së vdekurish, o Zot, paçe lëvdi!

VII

E prishe me krikjen Ti vdekjen i sbille kusarit
Parraisin të Miroforëvet vajin i prore e Apostojvet t'atë
urdhurove të leçitiën: se u ngjalle, o Krisht Perëndi,
tue i dhënë' jetës të madhen lipisi.

VIII

S'larti u sdripe, o i përmallshëm, te varri tri ditësh Ti
hire, nga epshet t'ona t'na lirosh, o Gjella e Ngjallia
jonë lëvdi Tij , o i Madh'in'Zot.

TYPIKA TE MESHA

TYPIKA TE MESHA

Bekò, o Shpirti jim t'ën' Zonë.

I bekuar je Ti, o Zot.

(Ms.102) Bekò, o Shpirti jim, t'ën' Zonë e gjithë të brendëshmit e mia embrin e' tij të shejt.

I bekuar je Ti, o Zot.

Bekò, o shpirti jim, t'ën' Zonë, e mos harrò gjithë të mirat që Ai të ka dhënë.

Atë që ndëjen gjithë ftesat t'ote e që shëndosh gjithë sëmundat t'ote.

Atë që shpërblen nga mortia gjellën t'ënde e që kurorëzon Tij me ndëjesë e lipisi.

Atë që tsin me të mira dishirimin t'ënt; do t'përtërihet si ajò e shkjipes, dielmëria jote.

In'Zot ka lipisi e bën ligjë gjithë atireve që durojnë të paligjë.

I dëftoi dhromet e' Tij Moseut, të bijëvet e Israelit popullit e' Tij.

Jep ndëjesë e isht i lipisiar in' Zot, zëmbërë gjerë e gjithë mirësi, jo për gjithëmonë do t'jet i zëmëruar, jo për jetë të jetëvet do të mbanjë mbri.

Ngë ka bërë pas ftesavet t'ona; ngë ka paguar pas mëkatëvet t'ona.

Se sa e lartë isht Kjiellia nga dheu, akjë të madhe e ka bër in 'Zot lipisin e 'Tij mbi ata që i trëmben.

Sa mban të lerit e diellit nga perëndimi, akjë ka mbajtur llargu nesh ftesat t'ona.

Sa isht i lipislar një print për bijët, ashtu ka klënë i lipislar in 'Zot për ata që i trëmben; se Ai njeh si jemi të geshur e kujton se jemi plëh.

Njeriu: si bari janë ditët e 'tija; si lulëja e fushës ai lulëzon.

Sa shkon era mbi Atë e ai ngë isht më e mosnjeri njeh më vendin e 'tij.

Po lipisia e T'in' Zoti nglatet mbë jetë të jetëvet mbi ata që i trëmben.

E drejtësia e 'Tij mbi të bijët e të bijëvet për ata që ruajën dhiatën e 'Tij e që kujtojnë urdhurimet e 'Tij sa t'i ruajën.

In 'Zot te kjiellia dërtoi troni e 'Tij e rregjëria e 'Tij mbi gjithëkjish zotëron.

Bekoni t'ën 'Zonë gjithë ju Ëngjëjit e 'Tij, të fortë me fukji,ju që bëni fialën e 'Tij, që mirrëni veshë zërin e fialëvet e'tija.

Bekoni t'ën 'Zonë ju të gjitha sa jini punët e 'Tija në

çëdo vend të zotëris s' Tij: Bekò, o shpirti jim,t'ën 'Zonë.

Lëvdi past Ati...nani...Amin.

Bekò, o shpirti jim,t'ën 'Zonë, e gjithë të brëndëshit e mia embrin e 'Tij të shejt.

I bekuar je Ti, o Zot.

Lëvdi past Ati e Biri e Shpirti Shejt...(Ms. 145)

Lëvdò, o shpirti jim, t'ën 'Zonë: ka t'lëvdonjë t'ën 'Zonë te gjella jime; ka t'këndonj Perëndin t'im njer që të jem.

Mos besoni në të Parët, në të bijët e njerëzëvet te të çilët ngë isht shëndëtë.

Ka t'i danjë shpirti i 'tij e do të priret te dheu i 'tij.

Tek ajo ditë të gjithë ka të prishen të gjithë mendimet e 'tij.

Lumë ai kuj Perëndia i Jakobit ë ndihma; e shpresa e 'tij në t'ën 'Zonë,Perëndia i 'tij.

I çili bëri kjielliën e dheun e dejtin e gjithëkjish sa janë tek ata.

I çili ruan të vërtetën për gjithëmonë e bën ligjë atireve që durojnë të paligjë e jep të ngrënë atireve që kanë uri.

In 'Zot sglith të lidhurit; in 'Zot ndrit të verbërit; in

'Zot ndrekj të kurrusmit; in 'Zot do të drejtit; in 'Zot ruan të huajit.

Të varfërin e të ven Ai mburon e dhromin e i të likjëvet shkatarron.

Ka t'rregjëronjë in 'Zot mbë jetë të jetëvet, Perëndia jit, o Sion, jini pas jinie.

Nani...Amin.

O i vetmi Bir e Fialë e Perëndis, Ti çë je i pavdekëshim, deshe të njerëzoneshe e të mirrie kurmë për shëndetën e shpirtit t'ënë në gji të Shejtes Mëmë e Povirgjërë e Shën Mëri.

Ti çë pandërruar Njeri u bëre e vunë n'krikj, o Krisht o Perëndi, me mortien t'ënde mortien shkele, Ti çë je një nga Trinia Shejte i bashkëlëvduar me Atin e me Shpirtin Shejt, jipëna gjellë të pasosme.

LUMËRIT

(Në vent të të tretës Antifonë)

Te Rregjëria jote kujtoui për ne, o Zot, kur të veç te rregjërria jote.

Të lumë të vapkjit në shpirt, se e 'tiria isht rregjëria e kjielliavet.

Të lumë ata që klanë, se ata ka t'jenë ngushëlluar .

Të lumë të butit, se ata ka të trazhgojën jetën.

Të lumë ata që kanë uri e etë ligje, se ata ka t'jenë tsitur.

Të lumë lipislarët, se ata ka t'gjejën lipisi.

Të lumë ata që kanë zëmbren e pastërë, se ata ka t'shohiën Perëndin.

Të lumë pakjësorët, se ata ka të thriten bij të Perëndis.

Të lumë ata që janë të përzën për drejtësin, se isht e 'tiria rregjëria e kjielliavet.

Të lumë jinë ju kur ju shajën e kur ju përzën, e kur ju thonë që d'fialë të liga me të rreme paj t'meje.

Gëzoni e bëni hare, se e madhe do t'jet rroga juaj te kjiellia.

Levdi...nani...

TETË ZËRET TË LUMËRIVET

I

Për të ngrënit armiku jashta Parraisit shtu Adhamin; po për krikjen Krishti atie këlliti Kusarin, i çili thrisëj: kujtou për mua kur të veç te Rregjëria jote.

U i falem Pesimevet t'atë, e lavdëronj t'Ngallurit t'atë, bashk me Adhamin e me Kusarin me zër të mathë u thërres: kujtou për mua, o Zot, kur të veç te Rregjëria jote.

Lëvdi...

Adhurojëm Atin e lëvdojëm Birin e bashk tërëshejtin Shpirt të gjithë imnojëm tue luritur e tue thënë: O Tërëshejtia Trini, Shpëtona të gjithëve.

Nani...

Mëmën t'ënde t'vu përpara për lutie populli jit, o Krisht; me ndërmietimet e 'saj, o i Mirë, sa na t'lëvdojëm Tij çë nga varri na u duke.

II

Zërin e Kusarit tek Ti ngrëjëm e thrresiëm: Kujtou për ne, o Shelbues, te Rregjëria jote.

Për ndjesë të mëkatëvet na Krikjen t'vum përpara çë nglakove për ne Ti çë do mirë njerëzin.

Lëvdi...

Atin lavdërojëm, Birin adhurojëm, të gjithë edhe

Shpirtin Shejt me besë imnojëm.

Nani...

Falem, o thronë, fitërë ziarri, falem, o Nuse e panusërte, falem, o Virgjërë, ç'Perëndin për njerëzit linde.

III

Kur shkeli, o Krisht, urdhurimin t'ënt, shtërgjishin Adham nga Parraisi e përzëre; po Kusarin, o i lipisiar, e bëre të hij atje, kur mbi Krikjen të njohu tue thirrur: për mua kujtou, o Shelbues, te rregjëria jotë.

Kur neve të mëkatruamë Ti na dënove me mallkimin e morties, o Gjellëdhënës e Zot, na dhe gjellë neve të vdekurë çë thrresiëm: Kujtou edhe për ne te rregjëria jote.

Lëvdi...

Atin edhe Birin, e Shpirtin Shejt imnojëm, o të besmë, një Perëndi, një Zot, si nga një Diell; se ntrish-driçme e Trinia, e ndritson gjithë ata çë thërresiën: kujtou edhe për ne te Rregjëria jote.

Nani...

Falemi, o dera e Perëndis, nga e çila shkoi kur u bë njeri Kriuesi tue ruajtur Tij të pangarë; falemi, mjegullë e hollë çë na bie Krishtin, shi të hyiinushëm; falemi, shkallë e thron i kjiellëshëm; falemi, mal i perëndeshëm, i majëmë, i paprerë.

IV

Për një dru Adhami nga Parrajsi kle përzënë; po për drurin e Krikjes te Parraisi hiri Kusari. Se ai tue ngjepsuar pemën urdhurimin shkeli të Kriuesit; po ki i vunë bashk n'krikj, njohu Perëndin të fshehur: kujtoui për mua, tue thirrur, te Rregjëria jote.

O Ti që vunë n'krikj, e që fukjin e vdekjes sglidhe, e që shuajte si Perëndi të shkruamen kundra nesh, o Zot, pendimin e Kusarit, o Ti që vetëm do njerëzit, jip neve që me besë t' lutëjëm, o Krisht o Perëndia jinë, e t' thëresiëm: kujtoui edhe për ne te Rregjëria jote.

Lëvdi...

Me një mendje të gjithë po të lutëjëm, o të besmë, sa të lëvdojëm si na nget Atin, Birin e Shpirtin Shejt, të çilët në tre vetë janë një i vetëm Perëndi, njëësi e papërzieme e thjesht e pandarshme e pa-afruashme, për të çilën na shpëtonemi nga ziarri i Pisës.

Nani...

Mëmën t'ënde, o Krisht, që prej Shpirtit Shejt të lindi e pas lindies vërtetani mbeti Virgjërë e dëlirë, Atë biem përpara Teje për ndërmietim, o Rrekj mëshirplot, ndëjesen e mëkatëvet të japësh kurdoherë kuj tek Ti thërret: kujtoui edhe për ne te Rregjëria jote.

V

Kusari mbi Krikjen tue besuar se Ti je Perëndi, o Krisht, të njohu me thjeshtësi nga thelpi i zëmbës, kujtoui për mua, tue thirrur, o Zot, te Rregjëria jote.

Me mortien t'ënde, o Krisht, fukjin e morties sglidhe e ngjalle bashk të vdekurit të motçëmë të çilët imnojën Tij, i vërtetë Perëndi e Shelbuesi jin.

Lëvdi...

Trini e pandarshme Njëësi, e gjithësis kriuese e tërëfukjishme, Ati edhe Biri e Shpirti Shejt, Tij imnojëm çë je i vërtetë Perëndi e Shelbuesi jinë.

Nani...

Falemi, o Faltore e shpirtësuasme të Perëndis, e derë e pashkuarshme; falemi, o Thron i padhezur e si ziarre; falemi, o Mëma e Emanuelit, Krishtit Perëndis t'ënë.

VI

Kujtjou për mua, o Perëndi Shelbuesi jim, kur të veç te Rregjëria jote e shpëtomë, si i vetëmi çë do mirë njerëzin.

Për një dru Adhami kle gënjier, për drurin e Krikjes pameta shpëtove Kusarin çë thërrisëj: kujtjou për mua, o Zot te Rregjëria jote.

Lëvdi...

Atin e Birin lavdërojëm edhe Shpirtin Shejt tue thënë: Shejtia Trini shpëto shpirtrat t'anë.

Nani...

O Ti çë paj të Shpirtit Shejt linde Krijuesin t'ënt, o Virgjërë, shpëtò neve çë të madhërojëm.

VII

E bur' isht e e bukurë për të ngrënë pema që më pru mortien. Krishti ë druri i gjellës, se në hëngrësha nga ai ngë vdes; po thrres bashk me Kusarin: kujtou për mua, o Zot te Rregjëria jote.

Mbi Krikjen lartësuar, o i lipisiar, dorëshkrimin shkijorre të mëkatës s'vjetrë të Adhamit e shpëtove nga gënjimi gjithë jinit e njerëzëvet; andai imnojëm Tij, o Zot mirëbërës.

Lëvdi...

Dritë isht Ati, Dritë isht Biri e Fialë, Dritë isht Shpirti Shejt po të tria janë një Dritë, se një Perëndi isht në tre vetë e në një nature e në të zënë fillë, i pandarshëm e i papërziem.

Nani...

Ti linde Birin e Fialë të Atit në mish mbi dhet, si Ai vet, o Mëma e Perëndis, e llojasi; andai, o Virgjërë e Mëmë, të sivasurë me Perëndin për Tij, na thrresiëm: të falemi, shpresa e të Krështerëvet.

VIII

Kujtou për ne, o Krisht Shelbuesi i jetës, si u kujtove mbi Krikjen për Kusarin, e bën na t'gjithëve t'mirë, o i vetëm i lipisiar, për rregjërën t'ënde të kjiellëshme.

Mirr vesh, o Adham, e gzou bashk me Evën, se ai që ju zveshi të dive kjëmoti e që me gënjim ju bu shkleftë të 'tij në Krikjen e Krishtit kle shtipur.

Lëvdi...

O Trini e panisurë, klënie e pandarshëme, Njëësi në një thron, e bashknderuashme në lëvdi, Naturë mbi të nisurat e Rregjiri, shpëtò ata që me besë t'imnojën.

Nani...

Të falemi, o vent i gjerë i Perëndis, Të falemi, o arkë e Dhiatës s're, Të falemi, shtamnë e artë nga e çila të gjithëve kle dhënë manna e kjiellëshme.

TRISAJON
TË TË VDEKURËVËT

TRISAJON TË TË VDEKURËVËT

Bashkë me Shpirtrat të drejtë e të mbaruamë, prej Shpirtrat e shërbëtorëvet t'atë, o Shelbues, e ruaj ata te jeta e lume ç'isht pranë Teje, Ti çë do mirë njerëzin.

Te prëhia jote, o Zot, tek u gjithë Shejtrat t'atë prëhen, prej Ti edhe shpirtrat e shërbëtorëvet t'atë, se Ti vetëm je i pavdekëshim.

Lëvdi...

Ti je Perëndia jinë çë u sdripte te Pisa, e çë sglidhe dhëmbimet e të lidhurvet, prej Ti edhe shpirtrat e shërbëtorvet t'atë, o Shelbues.

Nani...

E vetmia e kulluame dhe e pangar Virgjëreshë, çë Perëndin paj të Shpirtit Shejt linde, ndërmjetò sa të shpëtonen shpirtrat e shërbëtorëvet t'atë.

Kijna lipisi, o i Madh'in'Zot, paj të madhes lipisis s'ate, na të parkalesiëm, Ti gjegjëna e kijna lipisi.

Lipisi, o i Madh'in'Zot.

Edhe të parkalesiëm për prëhien e shpirtravet e të ndëjemëvet shërbëtorë të Perëndis (...) e sa t'i ndëjenen atire gjithë ftesat të bëma tue dashur e pa dashur.

Sa i Madh'in'Zot, Perëndia jinë, t'i japënjë vent shpirtravet të atire tek u prëhen të drejtitë. Lipisin e t'in'Zoti, Rregjërin e kjielliavet e ndëjesën e mëkatëvet

t'tire nga Krishti, i pavdekshmi Rrekj e Perëndia jinë,
lipëmia, P. Gjegjëna, o i Madh'in'Zot.

Parkalesiëm t'ën'Zonë.

O Perëndi i shpirttravet e i gjithë kurmëvet, që shkele
mortien e munde e shtipe diallin e i dhe gjellë jetës
s'ate, Ti, o i Madh'in'Zot, jip prëhie shpirttravet e të
ndëjemëvet sherbëtorë t'atë (...) në vent të dritës, në
vent të gëzimit, në vent të dhrosis, tekun ngë isht
dhëmbim, lipë e psherëtim.

Çëdo mëkatë që ata kanë bërë me të fola, me të bëma, e
me tru, Ti që je i mirë, o Perëndi, e që do mirë
gjithënjeri, ndëjeja. Se ngë isht njeri që rron te jeta e
ngë mëkatron, se Ti vetëm je i pa mëkatë; drejtësia
jote isht drejtësi për gjithëmonë e fiala jote isht e
vërteta.

Se Ti je ngjallia, gjella e prëhia e të ndëjemëvet
sherbëtorë t'atë (.) o Krisht Perëndia jinë e na japiëm
lëvdi Tij bashkë me Atin t'ënt të pazënë fill e bashkë
me gjithë shejtin e të mirë e gjellëdhënës Shpirt t'ënt
nani e për gjithëmonë e për jetë të jetvet. Amin.

Jipi prëhie, o Zot, shpirttravet të të vdekurëvet të
krësherë orthodoxë, në vent shejt e në horë të të
drejtëvet, prit ata shpirttra, o Shelbues, e jipi prëhie.

(Në i vdekuri ë Prift thuhet):

Të haristisiëm, o i Madh'in'Zot, përçë vetëm jiti isht të
rruarit pa vdekje, përçë lëvdia jote isht e pandël-
guashme, e dashuria jote për njeriun e parrëfieshme e

rregjëria jote ngë i shkon njeriu e Ti ngë i merr anën njeriu.

Ti urdhurove se, kur të mbarojën kjëroin e gjellës s'tire, gjithë njerëzit të vdesiën.

Andai të parkalesiëm o Zot e i Zot, sa ki shërbëtor i jiti e vëllau i jinë, i çili na kle shokë te priftëria e pati besën tek Ti e rrëfiejti gjithëmonë e drejt dhe e pakjërtuashme e u kjëllua gjumi me shpresën e të ngjallurit e jetës të pasosme, të prëhet në gjì të Abramit, të Isakut edhe të Jakobit.

E si mbi dhe te Klisha jote e vure Prift te shërbesa e shejte, kështù le të marrënj pjesë te Theroria shejte e kjiellit. Mbi njerëzit Ti e stolise me një stoli shpirtullore, mbi Engjëjit e lëvdis s'ate Ti përte mire I padënuam. Ti i dhe lëvdi gjellës s'tij mbi dhe, Ti nani bëj sa Ai të hinjë e uje në mes të Shejtavet t'atë, tue e nëmuruar shpirtin e 'Tij me gjithë atà që moti Tij pëlkjieshmë, Se Ti je ngjallia...

TE DITA E GJITHË TË VDEKURVET

Edhe të lutemi për të lumen kujtesë dhe të përjetëshmen prëhie të gjithë të ndëjemëvet të krështerë orthodoxë Rregjëre, të Parë, Patriarkëra, Jerarhë, Priftra, Jerokallogjerë, e Kalogjëresha, Atëra, Propatorë, Gjishëra, Shtërgjishëra, që nga të parët njera te të sprasmitë e sa t'i ndëjenen atireve gjithë ftesat të bëma tue dashur e pa dashur.

Dituri !

Bekona, o Zot.

Ju bekoft Krishti Perëndia jinë i vertetë nani....

Amin.

Lëvdi Tij, o Perëndia jinë, shpresa e gjithë neve, lëvdi Tij.

Lëvdi....nani...Bekona,o Zot.

Zoti Krisht, i ngjalluri se vdekurish, i vërteti Perëndia jinë, paj të Povirgjërës e Shën Mëri, me fukjin e Krikjes shjte, çë jep gjellë, e paj të Apostojvet të lëvdushëm e embërschkëlkjierë e t'Atëravet t' anë të ndershme e theoforë, vufshit në vent të të drejtëvet edhe shpirtrat e shërbëtorëvet t'tij, çë ngak na u ndajtën tue ndërruar jetë. I dhëfshit prëhie në gji t'Abramit, i nëmërofshit ndër të drejtitë e neve na paçit lipisi si i mirë e çë njeriun do mirë. Amin.

I përjetëshëm kloft kujtimi i tire (Tri herë)

Edhë ndëjeja, o Zot.

Ashtù kloft.

Kloft kujtimi i'tire i përjetëshëm.

Edhe ndëjeja, o Zot.

Ashtù kloft.

DITTICI

DITTICI

SHEJTES TRINI'

Gjithë lëvdojëm bukurë me këнка të frimëzuara: Atin, Birin e Shpirtin Shejt, Trini e pushtetëme e Njëni mbretërore, e Zotrim.

KRIKJES

U lëvdonjë Krikjëzimin t'ënt, o i Mirë, imnonjë Pesimet t'atë edhe i përmisem Varrit t'ënt, gozhdavet, shtizës, kallëmit e shpuzës, të gjitha i nderonjë, o i Madh'in'Zot, i lipisiar.

ËNGJËJIT

Ëngjëjish të gjithë ju ushtri. Prinjës i t'in'Zoti, o Apostoj të dimbëdhietë, e të lumësh godhë me Mëmën e t'in'Zoti, o ju ndihmë të na jipëni shpëtim për të pasuar na.

Mikelli Arkëgëll i Krishtit, mos të vishë si luan, I tërbuar me shpirtin t'imë si një zogë, te hera e vdekies, Ti ndihmomë.

SHËN JANI PAËGZOR

Prodhromë të t'in'Zoti e Pagëzor, rrëmp i diellit 'ill i menatës, çë jep dritë, ndritësò Ti shpirti t'imë të mjerë, i errët nga sulmimet e gjellës.

APOSTOJIT

I hjinushëm Pietër kjerr hjeruvik, i kjiellëshëm Pal, kjerr serafik,gluhë e dhezurë të Fialës Perëndi-njeri, liromë nga zjarri i Pisës.

SHËN KOLLI

Mburonjës i të varfërit e i të vejavet, ushkjies i të urmit, mirëbërës i të vapëkjëvet, mbronjës i të burgosurëvet, shpëtues të atireve që lundrojën, je jini, o i lumë, Shën Koll i dishëmë.

S. JANI GOJART

Gëzou, o lumë me valat të arta, që potis me vije të artë gjithë jetën. Gëzou, gluhë e zëmbër të arta, o Gojat i lumë themelë të Patriarkravet.

SHËN VASIJI

Kjiell-folësin e Krishtit, dishipullin e Zotit, illin ndritëshëm, nga vendi i Kjesaris e të Kapadhokjëvet, Vasijin e mathë të gjithë nderojëm na.

S. GREGORI

Thësorin e Theolojis, e të përsosurin udhëhekjës të theologëvet, Delmerin e mirë e liturgin e Krishtit, Gregorin i Mathë, të gjithë lëvdojëm.

S. SPIRIDONI

Gëzou, o lumë famasmëshë, o Jatrua i të sëmurvevet e të helmuarvet, gëzou farë të mësimëvevet të shpirtit, Spiridhon të Trebisondës Delmer i mirë.

S. MITRI

Të madhin ushtar e trimin kurorëmbartësin të famashëmin ndër martrat, të plagosurin me shtizë në brinjë si in'Zot, hjinorin Dhimitër me imne nderojëm.

Mbrò shërbëtorët t'atë, o luftar deshmor Mirovllit, që

të nderojën me përshpirtëri, e largoi rrëzikje e çëdò demë t'jetër Dhimitër tri herë i bekuar me ndërmjetësìn t'ënde.

S. GJERGJI

Nga gjithë shumiza e të besmëvet kleve vunë si ill i shkëlqjiem të Kapadhokjes, i madhi Athlet të Krishtit, Deshmor Dritar Shën Gjerkjë i Mathë, çë na sot nderojëm.

TRE JERARKRA

Ejani, o të besmë, imnojëm tre Jerarkrat të mëdhenjë e të ndritur: Vasijin baskë të dishmin Gregor e me të madhin Janë, gjithë lëvdojëm.

SHEJTIA MARIN

Nderojëm të gjithë, llëmpën çë dritëson, thësorin i pangar të virgjëris, Nusia e t'in'Zoti, kjenkja e pamëkatë, Shejtia Marin.

S. ANË

Ejani, o të besmë, lëvdojëm Shejtie Anë, Gjishja e Krishtit, çë kle bër e mirë të lindjë Virgjërën e vetmia Mëmë të Perëndis gjithë e pastëra.

TË VDEKURIT

Jipi prëhie, o Zot, shpitravet të të vdekurëvet të krështerë orthodoxë, në vent shejt e në Horë të të drejtëvet, prit atà shpirtra, o Shelbues, e jipi prëhi.

SHËN MËRIS

Zonjë çë na prure kë pru shpërblim vëri vesh lusivët shërbëtorësh të pa vleftë sa të jesh pastore përpara Atij çë linde, o Zonjë e madhe e jetës, bënu ndërmjetësë.

Diak.: Bekò, o Zot, Bukën Shejte.

Prifti: + E bëj këtë Bukë, Kurmë të strejt të Khrishtit t'ënt.

Diak.: Amín.
Bekò, o Zot, Kjelkjin Shejt.

Prifti: + E atë që isht te Kjelkjë Gjakë të strejt të Khrishtit t'ënt.

Diak.: Amín.
Bekoi, o Zot, të dia bashkë.

Prifti: Tue i ndërruar me anën e Shpirtit t'ënt të Shejt.

Diak.: Amín, Amín, Amín.

Prifti: Sa të jenë për ata ç'i marriën pies të lar Shpirti, të ndëjer mëkatshë, bashkim me Shpirtin t'ënt te Shejt, për plotësin e rrëgjëris e kjielliavet; të rrijtur pa dre përpara Teje, jo për të gjëkuar, jo për të dënuar.

Edhe të dhurojëm këtë Flijë të mendçeme për ata që u kjëlluan me besë: Prindra të parë, Atëra, Patriarkëra, Profetëra, Apostojë, Ligjëronjës, Vangjejtare, Deshmorë, skomollerë, të Përkorë, e nga shpirt i drejt që ngak na u nda tue ndërruar jetë i përsosur te besa.

Më se më për Mëmën e Perëndis, gjithë shejte, të dëlirë, të bekuame edhe të lëvduame: Zonjën t'ënë Po-Virgjërë e Shën Mëri.

Pop.: I mathë isht embri i Trinis shejte.

Shumë mir'isht me të vërtetë sa të thomi Tij të lume Zonjë, për gjithëmonë t'lumëshme dhe të papërlieme edhe Mëmë të të Madhit Zot.

Tij më të nderoshme se Hjeruvimt e pa të përkrahur më të lëvdoshme se Serafimt, çë pa fare u ndotur të lartën Fialë linde, vërteta Mëma t'Zotit, po madhërojëm na.

Prifti: Për Shën Janin profetë paradhromë e pagëzor, për shejtrat, të levduashmit e embërskkelkjer Apostojë, për Shejtin (...) çë sot kujtojëm e për gjithë shejtrat t'atë paj të parkalesivet të tire Ti, o Perëndia jinë, prir siun mbi ne.

Prifti kujton sa do të të vdekurit.

E kujtou për gjithë ata çë ndërruan jetë me shpresën te të ngjallurit e gjellës të pasosme (...) e jipi prëhie atire (o atiji) te ku shkëkjën drita e fakjes s'ate.

Edhe të parkalesiëm, o i Madh'in'Zot, kujtou për gjithë Despotërin e vërtetë, çë shpalë

drekjē fialën e të vërteties s'ate.

Kujtou për gjithë Prifterin, për Diakonin në Krisht e për gjithë rradhët priftërore.

Edhe të dhurojëm këtë Flijë të mendçëme për gjithë jetën, për Klishën shejte katolike e apostolike.

Për ata që shkojnë gjellën e dëlirë e nderme, për të Parët t'anë të besmë, për gjithë shpin e ushtrin e 'Tire.

Ti, o i madh'in 'Zot, jipi atire rregiërin në pakje, sa edhe na në pakjen e 'tire të shkojëm gjellën t'ënë e pakjëshëme dhe e kjetëshëmje në gjithë lutësi e nder.

Me zërë të lartë: Ndër të parët kujtou, o i Mad'in 'Zot, për Episkopin t'ënë (...) kuj Ti jipi të jet për klisht t'ote shejte: i ruajtur, i ndermë, me pakje, me shëndetë e me ditë të glata sa të ligjëronjë drejtë Fialën e të verteties s'ate.

Diak.: Edhe kujtou për gjithë ata që nga njeri nesh ka në mendie.

Pop.: Për të gjithë e për të gjitha.

Prifti: Kujtou, o i Madh'in 'Zot, për Horën te ku rrim e për nga kjetet edhe horë e për gjithë ata që rrojën me besë. Mos harrò, o i Madh'in 'Zot, ata që ndodhen mbi dejt, për në dhromë, të sëmure, që' jane e riejën e për ata që ran te'

duart e armikjëvet e për shëndetën e'tire.

Kujtoui, o i Madhi'in'Zot, për ata që bien
klishëvet t'ote shejte pemët e tire, e që
ndihien me vepra të mira; e për gjithë ata që
kanë kujdes për të vapkjit, e mbi ne të gjithë
të derthëshë lipisitë t'ote.

Me zërë të lartë: E jipëna sa me një gojë e me
një zëmbërë të lëvdojmë e të këndojmë të
gjihëndershmin e të madhëruashmin embër
t'ënt: të Àtit, të Birit, e të Shpirtit Shejt, nani
e për gjithëmonë e për jetë të jetëvet.

Pop.: Amín.

Prifti: E lipisitë e të Madhit Perëndi e Shpëtuesi
jinë Iisu Krishti, klofshin me ju të gjithë.

Pop.: Edhe me shpirtin t'ënt.

Diak.: Posa kemi kujtuar gjithë shejtrat, pameta në
pakje, parkalesiëm t'ën' Zonë.

Pop.: Lipisì, o i Madh'in'Zot.

Diak.: Për të shtrejtat Dhurata paravuna e të
shejtëruame, parkalesiëm t'ën' Zonë.

Sa Perëndia jinë, që njeriun do mirë, e ç'i
mori me hirë mbi shejten Therorë t 'Tij të
kjiellëshëm e të mendçëme si bukurë erë
shpirtullore, nani na dhëfshit Hirin të
perëndishë e dhuratën e Shpirtit shejt,

parkalesiëm t'ën'Zonë.

Sa të na ruanjë nga çedò helme, mbri,
rrëzikje e mieri, parkalesiëm t'ën'Zonë.

Ndihna, shpëtona, kijna lipisi dhe ruana, o
Perëndi, me hirin t'ënt.

Posa lipëm njënin e besës e të marrit pies te
Shpirti Shejt, na njeri me t'jetrin e gjithë
gjellën t'ënë i truajëm Zotit Krisht Perëndi.

Pop.: Tij, o i Madh'in'Zot.

Prifti: Tij, o i Madh'in'Zot, me ne i mirë të truajëm,
gjithë gjellën t'ënë e shpresën t'ënë! Të par
kalesiëm, të lipiëm e të thomi: Bënnja të mirë
të marriëm pies me ndërgjegje e pastërë te
këta Mistere të kjiellëshëm e të dreruashëm
të kësaj TRIESIE shejte e shpirtullore; për
ndëjesë të mëkatëvet, për falien e ftesavet,
për pies te Shpirtit Shejt, për mbarin të
Rregjëris së kjielliavet, për të rrijtur pa dre
përpara Teje, jo për gjikim, jo për dënim.

E bënnja të mirë, o i Madh'in'Zot, sa me besë
e pa ftesë të kudsojëm të të thërresiëm Tij
TATE, Perëndi i kjiellëshëm e të të Thomi:

ATI JINË

Pop.: ATI jinë çë je në kjiell, shejtëruar kloft embri
jit, arthët rregjëria jote, u bëftë vullimi jit, si
në kjiell ashtu në dhe. Bukën t'ënë të

përditëshme ëna neve sot, ndëjena dëtirët
t'ona ashtu si na ja ndëjejem të
dëtëruamëvet t'anë e mos na le të biem ndë
ngarie, po lirona nga i ligu.

Prifti: Se jotia isht Rregjëria, fukjia e lëvdia: e Atit,
e Birit edhe e Shpirtit Shejt, nani e për
gjithëmonë e për jetë të jetevet.

Pop.: Amin.

Prifti: Pakje të gjithëve.

Pop.: Edhe shpirtit t'ënt.

Diak.: Ujëni kriet t'ajë t'in'Zoti.

Pop.: Tij, o i Madh'in'Zot.

Prifti: Të haristisiëm, o Rrekj i padukshëm, çë bërë
gjithkjish me fukjin t'ënde të pamaturë e çë
thërite të gjitha nga e mosklëna në të klënitë
me të plotën lipisi t'ënde.

Ti, o i Madh'in 'Zot, prir siun nga kjiellia mbi
këta çë Tij ujën kriet e'Tire, se ngë e ujën
përpara mishit o gjakut, po përpara Teje,
Perëndi i trëmbëshëm.

Ti pra, o i Madh'in'Zot, bëjna dhromë për të
mirën e gjithë neve, si nga njeriu i duhet:
lundrò bashkë me ata çë janë e lundrojën,
jits bashkë me ata çë janë e jetsiën, jipi
shëndetë të sëmurvet, o Jatrua i shpirttravet

e i kurmëvet t'anë.

Me zërë të lartë: Me Hirin, me lipisitë e me mirësin që ka me ne jit Bir i vetmi ler, me të çilin je i bekuar, bashkë me të gjithëshejtin, të mirë e gjellëdhënës Shpirt t'ënt, nani e për gjithëmonë e për jetë të jetëvet.

Pop.: Amin.

Prifti: Gjegjëna, o i Madh'in Zot, Iisu Krisht Perëndia jinë, nga ndenja jote e shejte e nga throni i lëndis së Rregjëris s'ate, edhe eja të në shejtëroshë, Ti që rri së larti ujur me Atin e që këtu paparë me ne ndodhe: e të na bësh të mirë me dorën t'ënde të fukjishme të na japëshë neve Kurmin t'ënt të dëlirë e Gjakun t'ënt të shtrejtë, e me duartë t'ona gjithë popullit.

Ndëjemë, o Perëndi, mua të mëkatruam e kijëm lipisi.

Diak.: Vumëji're!

Pop.: Për ndihmë të gjithë të besmëvët të krështerë të vërtetë.

Prifti: Të Shejtët Shejtravet.

Pop.: Një i Shejti, një i Zoti, Isu'Krishti, në lëvdi të Atit Perëndi. Amin.

Diak.: Çajë, o Zot, Bukën Shejte.

Prifti: Çahet e bënet piesë piesë Kjenkji i Perëndis, i çili çahet e ngë ndahet e gjithë herët hahet po ngë soset, e shejtëron kushë i merrë piesë.

Diak.: Plotësò, o Zot, Kjelkjn Shejt.

Prifti: Plotësia e Besës të Shpirtit Shejt. Amin.

Diak.: Bekò, o Zot, Ujët e ngrohtë.

Prifti: Bekuar kloft ngrohtësia e besës së Shejtravet t'ate, gjithëmonë, nanì e përherë e në jetë të jetëvet. Amin.

Diak.: Ngrohtësia e besës, plotë me Shpirt Shejt.

KINONIKON

Tek e Diella: Lëvdoni t'ën'Zonë ju nga kjiellia; lëvdonie Atë te m'i larti kiell. Alliluia.

Tek e Hërnia: Ai që bëri frima Engjëjitë e 'Tij e shëbërtorë t'Tij flaka ziarri. Alliluia.

Tek e Martia: Në kujtim të pasosmë ka të jet i drejti; e ngë ka të trëmbet për zërë të kekjë. Alliluia.

Tek e Mërkuria: Kjelkjin e shëndeties u dua të marrë e embrin e t'in'Zoti u dua të thërres. Alliluia.

Tek e Intia: Te gjithë jeta dolli zëri i'tire, te gjithë anët e botës fialët e'tire. Alliluia.

Tek e Prëmtia: U dëftua mbi ne drita e fakjes s'ate, o i Madh'in'Zot. Alliluaia.

Tek e Shtunia: Të lumë ata që Ti ke sgledhur e që ke pritur mirë, o i Madh'in'Zot, kujtimi i'tire bres pas brezi. Alliluaia.

Prifti lutet tue thënë:

U kam besë, o i Madh'in'Zot, se Ti je vërteta Krishti i Biri i Perëndis të gjallë, që jerdhe te jeta të shpëtoje të mëkatruamit, ndër të çilët i pari jam u.

U kam besë edhe se ki isht pë' ftetë Kurmi jit i dëlirë e ki isht Gjaku jit i shtrejt. Andai Të parkales: kij lipisi per mua e ndëjem gjithë mëkatë t'ime, bërë tue dashur e padashur, me fialë, me të bëma, tue dijtur e pa dijtur. E bëjëm i mirë të marrë pies, pa dre dënimi, te Misteret t'atë të pasosmë, për ndëjesë të mëkatëvet e për gjellë të pasosme. Amin.

Të darkës t'ënde mistike, o i Biri i Perëndis, vur sot në pies edhe mua; se u armikjëvet t'atë misterin t'ënt u ngë i thomë, e ngë të puth si të puthi Judha, po si Kusari i mirë u të thomë: për mua kujtou, o Zot, o Krisht, o i Shejt te Rregjëria jote.

Mos më kloft për gjikim o për dënim këta të marrë pies te misteret t'atë shejt, po kloft për shëndetë të shpirtit e të kurmit.

Prifti kungonet tue thënë:

Prifti shërbëtori jit (•) kungonet me Kurmin e Gjakun shejt të t'in'Zoti, shëndeta jone, për ndëjesë të

mëkatëvet e për gjellë të pasosme.

Prifti: Diakanë, kjasu!

Diak.: E ëmë, o Zot, të shtrejtin e të gjithëshejtin Kurm të t'in'Zoti, Perëndia e Shpëtuesi jinë lisu 'Krishti, për ndëjesën e mëkatëvet t'ime e për gjellën e pasosme.

Prifti: Tij...diakanë, isht dhënë i shtrejti, i gjithëshejti e i dëliri Kurm të t'in'Zoti, Perëndia e Shpëtuesi jinë lis'Krishti, për ndëjesën e mëkatëvet t'ote e për gjellën e pasosme. Amin.

Diakanë, pameta kjasu!

Diak.: Pameta kjasemë Rregjit i pavdekëshëm. Ëmë, o Zot, edhë të shtrejtin e të gjithëshejtin Gjak të t'in 'Zoti, Perëndia e Shpëtuesi jinë lisu 'Krishti, për ndëjesën e mëkatëvet e për gjellën e pasosme.

Prifti: Tij...diakanë, isht dhënë edhë i shtrejti e gjithë i shejti Gjak të t'in 'Zoti, Perëndia e Shpëtuesi jinë lisu'Krishti, për ndëjesën e mëkatëvet t'ote e për gjellën e pasosme. Amin.

Këta ngau buzët t'ime e do të ndsiernjë ftesat t'ime e ka të kjëronjë mëkatët t'ime.

Diakani me zërë të lartë thot:

Me trëmbësi të Perëndis, me besë e dashuri:
kjasij.

Pop.: Amin. Amin. I bekuar ai që vien në ëmbër të
t'in'Zoti: Perëndia Zot edhe na u dëftua neve.

Prifti kungon tue thënë:

Kungonet shërbëtori i Perëndis (...) me
Kurmin i shtrejt e me Gjakun gjithë i shejt të
Zotit dhe Perëndis dhe Shpëtimtarit t'ënë
Jisu Krisht për ndëjesë të mëkatëve të tija
dhe për gjellë të pasosme.

Si sosë të dhënit kungimin bekon popullin tue thënë:

Shpëtò, o Perëndi, popullin t'ënt e bekò
Trazhgimin t'ënt.

Pop.: Për shumë vietë, o Zot.

Pamë dritën e vërtetë, muartëm Shpirtin të
kjielliës, gjetëm besën e vërtetë, tue u falur
përmist Trinis të pandarshme, se kjo neve
na shpëtoi.

Prifti: Ngreu lart, o Perëndi, mbi kjielliat e lëvdia
jote shkëlqjeft mbi gjithë dheun. (Tri herë)

Bekuar kloft Perëndia jinë, (me zërë) përëherë
nani e për gjithëmonë e për jetë të jetëve.

Pop.: Amin. Për ndëjesë të mëkatëve e për gjellë të pasosme. Alliluia. (Tri herë)

Diak.: (Shtuara) Na çë u kemi kunguar me Misteret të Krishtit, të perëndishëm, të shejtë, të dëlirë, të pavdekshëm, të kjiellëshëm, gjellëdhënës, të dreruashëm, si nget haristisiëm t'ën' Zonë.

Ndihna, shpëtona, kijna lipisi dhe ruana, o Perëndi, me hirin t'ënt.

Posa lipëm të na shkonjë gjithë dita e mbaruame më se më, e shejte, me pakjen e pamëkatë, na e njeri me t'jetrin e gjithë gjellë t'ënë i truajëm Zotit Krisht Perëndi.

Pop.: Tij, o i Madh'in'Zot.

Prifti: Të haristisiëm, o i Madh'in'Zot, mirëbëresi i shpirttravet t'anë, pse edhe te kjò ditë na bëre të mirë të kjishëm pies te Misteret t'atë të pasosmë. Ndrekjë dhromin t'ënë, mbajna gjithve fortë te trëmbësira jote, ruajna gjellën t'ënë Fortësò mendimet paj të parkalesivet e të lutievet e Povirgjërës Shën Mëri, të lëvduashmes Mëmë të Perëndis e paj të gjithë Shejtravet t'atë.

(Me zërë) Se Ti je të shejtëruamit t'anë e na të japiëm lëvdi Tij: Atit, Birit e Shpirtit Shejt, nani e për gjithëmonë e për jetë të jetëve.

Pop.: Amín.

Diak.: Le të vemi në pakje.

Pop.: Në embër të t'in 'Zoti!

Diak.: Parkalesiëm T'ën'Zonë.

Pop.: Lipisi, lipisi, lipisi, o i Madh'in'Zot.
Bekona, o Zot.

Prifti: O I MADH'IN'ZOT, që bekon ata që të bekojnë
e shejtëron ata që tek Ti kanë besë: Shpëtò
popullin t'ënt e bekò Trazhgimin t'ënt.

Pop.: Për shumë viet, o Zot.

Prifti: Ruaj në pakje plotësin e Klishës s'ate,
shejtërò ata që duan hjen e shpis s'ate.
Amín.

Ti lëvdoi me fukjin t'ënde të perëndishme, e
mos na le neve që kemi shpresën tek Ti.
Amín.

Ti dhuroi pakjen jetës s'ate, Klishëvet t'ote,
Priftëris, të Parëvet t'anë, Ushtris e gjithë
popullit t'ënt. Amín.

Se çëdo të dhënë të mirë e çëdo dhuratë e
përsosurë vien s'larti, sdripet ngak Ti, Ati i
dritëvet, e na të Japiëm lëvdin, të
haristisurit, e të përmisurit Tij: Atit, Birit e
Shpirtit Shejt, nani e për gjithëmonë e për

jetë të jetëvet.

Pop.: Amín. Embri i tin'Zoti klofët i bekuar nani e për gjithëmonë. (Tri herë)

Prifti: TI, o Krisht Perëndia jinë, çë je mbarimi i ligjës e i Profetravet e çë mbarove gjithë Urdhurimet e Atit Perëndi, Ti mbloj me harë e gëzim zëmbrat t'ona, nani e për gjithëmonë e për jetë të jetëvet. Amin.

Diak.: Parkalesiëm t'ën'Zonë.

Pop.: Lipisi, o i Madh'in'Zot.

Prifti: Bekimi i t'in'Zoti e lipisia e'Tij arth mbi ju me Hirin e'Tij e me mirësin, përëherë, nani e për gjithëmonë e për jetë të jetëvet.

Pop.: Amín.

Prifti: Lëvdi Tij, o Perëndia jine, shpresa jonë, lëvdi Tij.

Pop.: Lëvdi past Ati, Biri, e Shpirti Shejt, nani e për gjithëmonë e për jetë të jetëvet. Amin.
Lipisi, lipisi, lipisi, o i Madh'in' Zot. Bekona, o Zot.

MBARIMI

Prifti: KRISHTI, Perëndia jinë i vërtetë, i ngjalluri së vdekurish, (i famasëshëm ndër shejtrat) për parkalesitë të Mëmës s'Tij, e dëlirë e pa

mëkatë, me fukjin e KRIKJES Shejte e
Gjellëdhënëse, për mbrojtiet të të
ndershmevet pushtetie të poshpirtëshme të
kjielliës, për lutiet e të ndershmit e të
lëvduashmit Profet e Paradhromë Shën Jani
Pagëzor, paj të lëvduashmëvet Shejtra
Apostoj të përmendëshim e të Shejtrat
deshmorë mundësorë, paj të Shejtravat Atëra
t'anë e të Atit t'ënë ndër Shejtrat Shën Jani
Gojarti e të Shejtëravet gjithëra të t'in'Zoti
Shën Jakini e Shejtia Anë, të Shejtit (...) që
sot kujtojëm edhe të gjithë shejtrat, na paçit
lipisi e na shpëtoft si i mirë e që njeriun do
mirë.

Pop.: Amín.